REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT DHE MIRËQENIES SOCIALE**
**DREJTORIA E POLITIKAVE TË PËRFSHIRJES SOCIALE**

**Raporti individual i konsultimit publik**

**për Projektvendimin**

**“ Për miratimin e Planit kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030”**

1. **Titulli i projekt aktit**

Projektvendimi " Për miratimin e Planit kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030”

2. **Kohëzgjatja e konsultimeve**

*Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.*

Projektvendimi “Mbi miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030, ka kaluar përmes një procesi të konsultimit publik, i cili është zhvilluar nga 22 Dhjetor 2025 deri në 4Mars 2026, me takimet e grupit të punës, takime me shoqërinë civile dhe takime me shoqërinë civile.

Njëkohësisht, Projektvendimi u publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik.
Kohëzgjatja e konsultimit publik për këtë akt ishte 20 ditë pune nga data e shpalljes së njoftimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publik.
Postimi për konsultim për këtë projektvendim u bë më datë data 30.03.2026 deri dhe u mbyll më datë 27.04.2026. Ky projektvendim rezulton të ketë patur 22 ditë gjatë kohëzgjatjes së publikimit në regjistër elektronik.
Përmes konsultimit ka patur 450 shikime. Nuk ka patur komente lidhur me dokumentin.

RENJK: https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/947

Gjithashtu dhe në ëebsite zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale:

https://shendetesia.gov.al/single-konsultimi/?id=947

Takimet e konsultimit në kuadër të procesit të hartimit të projekaktit, kanë nisur pas miratimit të Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nr 553, datë 11.11.2025, " Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës (GNP) për hartimin e raport progresit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025 dhe hartimin e Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026-2030".

Ato përfshijnë periudhën kohore nga muaji Dhjetor 2025 deri në muajin Mars 2026, me prezantimin dhe miratimin e këtij dokumenti kombëtar në Mbledhjen e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, të zhvilluar në datën 4 Mars 2026. Në këto takime kanë marrë pjesë anëtarët e GNP, pushte institucione të pavaruara dhe organizata të shoqërisë civile për/e personave PAK.

Gjatë procesit të hartimit të Planit janë zhvilluar një sërë takimesh konsultative dhe koordinuese me institucionet përgjegjëse, institucionet e pavarura, pushtetin vendor dhe organizatat e shoqërisë civile. Konkretisht:

- Takimi i Grupit të Punës me përfaqësues nga MSHMS dhe institucionet përgjegjëse e të pavarura për hartimin e Planit u zhvillua më 22 dhjetor 2025.
- Takimi për fushën e mbrojtjes sociale dhe strehimit social u organizua më 9 shkurt 2026.
- Takimi për fushën e shëndetësisë u zhvillua më 9 shkurt 2026.
- Takimi për fushën e aksesueshmërisë u zhvillua më 10 shkurt 2026.
- Takimi për fushën e drejtësisë u organizua më 10 shkurt 2026.
- Takimi për fushën e pjesëmarrjes në jetën politike dhe publike u zhvillua më 12 shkurt 2026.
- Takimi për fushën e bashkëpunimit dhe koordinimit u organizua më 12 shkurt 2026.
- Takimi konsultativ me bashkitë u zhvillua më 13 shkurt 2026 në format online, pas dërgimit nga bashkitë të përgjigjeve për pyetësorin përkatës.
- Takimi me organizatat e shoqërisë civile të/për personat me aftësi të kufizuara u organizua më 23 shkurt 2026.

## 3. Metoda e konsultimit

*Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese…, dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).*

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka zhvilluar procesin e konsultimit publik nëpërmjet:

-Publikimit të projektaktit më datë 30 Mars 2026, në regjistrin elektronik për njoftimet

dhe konsultimet publike;

-Publikimit në ëebsite zyrtare të MSHMS të projektaktit datë 30 Mars 2026 dhe paketës shoqëruese;

-Takimet me institucionet, institucionet e pavarura, organizatat e/për instiucionet e pavarura.

- Konsultime si në Këshillim Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar dhe Këshillin Konsultativ për Vetëqeverisjen Vendore.

**4.Palët e interesit të përfshira**

*Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.*

*Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.*

*Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.*

Në këtë proces janë përfshirë aktorë nga institucione të ndryshme, më konkretisht:

a. Këshillat konsultativ: Qeverisja Qendrore dhe Vetëqeverisja Vendore
b. Institucionet shtetërore dhe ministritë e linjës si: MA, MEI, MD, MF, MIE, MPB, AKPA, ASPA, DNJF, etj
c. organizatat e/për personat me aftësi të kufizuar
d. partnerët strategjikë.
e. Institucionet e pavaruara

Në vijimësi, projektvendimi është dërguar për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrin e Shtetit dhe Kryenegociatorin, Ministrinë e Shtetit për Pushtetin Vendor, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokatin e Popullit, Autoritetin e Mediave Audiovizive, Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Institutin e Statistikave, Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Agjencinë Kombëtare të Sigurisë së Informacionit, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Universitetin Politeknik të Tiranës, Shkollën e Magjistraturës, Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Shkollën Shqiptare të Administratës Publike si edhe Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës Shtetërore.

*1.* **Pasqyra e komenteve të pranuara me arsyetimin e komenteve të pranuara/ refuzuara**

Nga aktorët e interesuar ka patur propozime/komente për draftin, specifike dhe të përgjithshme.

| Çështjet e adresuara | Komentet | Palët e interesuara | Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar) | Arsyetimi |
|---|---|---|---|---|
| Punësimi dhe formimi profesional | • Zbatim i kuotës së punësimit dhe sanksione për mosrespektim.<br>• Akses në formim profesional dhe mbështetje në vendin e punës (mentorim, për suport).<br>• Përfaqësim në strukturat arsimore dhe përshtatje e arsyeshme në të gjitha nivelet.(punësimi dhe aftesimi) | Rrjeti i Organizatave për Personat me Aftësi të Kufizuara në Tiranë 1. Fondacioni Se Bashku 2. Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar (MEDPAK) 3. Fondacioni "Pema e Jetës" 4. ANAD 5. Fondacioni Doën Syndrome Albania 6. Caritas Albania 7. Club Kombëtar I Prindërve të Fëmijve me CSA &P.A.K/Autizmi Flet 8. Qendra Social - Kulturore “Edhe unë mundem “ 9. ADRF 10. Global Care Albania 11. | I pranuar | Janë vendosur masa për punësimin dhe nxitjen e punësimit dhe aktivitete lidhur me to. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Qendra TISS 12. Shoqata "Ndihmoni Jeten" 13. Qendrën "Lumturo Dhimbjen" | | |
| Fondi social i punësimit | Përfaqësim i organizatave në fondin social dhe mbështetje afatgjatë për punësim | Rrjeti i Organizatave për Personat me Aftësi të Kufizuara në Tiranë | | Është parashikuar në legjislacionin për punësimi |
| Pjesëmarrja në shoqëri | Kuota për përfaqësim dhe akses në aktivitete kulturore e sportive.(përfshirja politike) | Rrjeti i Organizatave për Personat me Aftësi të Kufizuara në Tiranë | I pjesshëm | Një masë e vecantë |
| Jetesa e pavarur | • Jetesa e pavarur Asistencë personale si bazë për deinstitucionalizim.<br>• Shërbime komunitare të zgjeruara dhe jetesë e pavarur<br>Shqiptar.<br>Në vend të "ndihmës personal" të përdoret "asistent personal". Sa më sipër të jetë pjesë e amendimeve legjislative.<br>- të zëvendësohet "kapaciteti ligjore" me "zotësinë juridike për të vepruar" për hir të koherencës në terminologji (shih pjesën e analizës të bazuar në raportin për zbatimin e PKVPAK të | Rrjeti i Organizatave | E pjesshme | Rrjeti i shërbimeve është parashikuar të zgjerohet në Strategjinë e Mbrojtjes Sociale |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | kaluar, perkatesisht pjesa e pare e dokumentit). Ky zëvendësim rekomandohet të kryhet kudo ku shfaqet “kapacitet ligjore”. | | | |
| Gjuha e shenjave | Njohja zyrtare e profesionit të interpretit të Gjuhës së Shenjave Shqipe dhe rritja e numrit të interpreteve përmes programeve universitare, bursave dhe skemave të certifikimit.Forcimi i mbështetjes arsimore për fëmijët që nuk dëgjojnë në arsimin e zakonshëm, përmes interpreteve të GjShSh, mësuesve të trajnuar dhe profesionistëve të specializuar, në të gjitha nivelet e arsimit. | E pjesshme | | Nuk ka bazë ligjore për softuerë ekranlexues ekzistues. |
| Gjuha e shenjave | Mbështetja institucionale dhe financiare për zhvillimin, standardizimin dhe pasurimin e Gjuhës së Shenjave Shqipe, përfshirë terminologjinë profesionale.<br><br>Mbështetja dhe përditësimi i vazhdueshëm i fjalorit online të Gjuhës së Shenjave Shqipe si burim zyrtar referimi. | ANAD | E pjesshme | Nuk ka ende një sistem për interpretim në distancë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Aksesueshmëria | Aksesueshmëria – (aksesi në informim, komunikim dhe media) të parashikohet edhe krijimi i versioneve speech-to-text në gjuhën shqipe, ndërsa te zëri në shqip i ekranlexuesve text-to-speech nuk është nevoja të theksohet "për të verbër", pasi u shërben edhe personave me lloje të tjera dëmtimi. Për më tepër, nuk kërkohet krijimi i softuerëve në shqip, por i zërit (sintetizatorit) shqip për | Rrjeti i organizatave | I pjesshëm | |
| Aksesueshmeria | Aksesueshmëria-E-albania - suport për individët që operojnë me kujdestar ligjor (numër telefoni i njëjtë). | Qendra "Xhonathan" | I refuzuar | Nuk është në fushëveprimin e Planit ndërsa është në fushën e të dhënave personale, ku ka një lëgjislacion që nuk është e mundur të mbulohet nga PKV, i cili ka fokus strategjik. |
| Masa për standardet e strehimit social | Trajnimi i detyrueshëm i personelit të institucioneve publike në komunikimin bazë me personat që nuk dëgjojnë dhe në procedurat e shërbimeve të aksesueshme. | MEI | I pranuar | |
| Riformulimi i masave për transportin dhe infrastrukturën | Masa të cilat të adresojnë zbatimin praktik në vend të përafrimit ligjor | MIE | I pranuar | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Mbledhja e statistikave për aftësinë e kufizuar | Kufizimet e anketave dhe përmiësimi i burimeve administrative | INSTAT | I pranuar | |
| Protokolli Fakultativ i OKB | Masa e veçantë e ratifikimit në plan | Avokati i Popullit | I pranuar | |
| Role dhe përgjegjësi në aksesueshmëri (ndërtim) | Rolet institucionale | UPT | I pjesshëm | Plani si dokument strategjik mbështetet në legjislacionin ndërsektorial, i cili është në fuqi për aksesueshmërinë. Në kolonën e institucioneve janë vendosur institucionet. |
| Përfshirja e pushtetit vendor dhe AMVV | Zgjerimi i rolit në disa fusha | MSHPV | I pranuar | |
| Sigurimi i arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet e sistemit arsimor, për nxënësit me AK. | Riformulimi i synimit për vitin 2030 mbi raportin mësues ndihmës/nxënës me AK | Ministria e Arsimit | I pranuar | N/A |